



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr. 5 , datë 28/03/2023

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE “PËR PËRDORIM TË
BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM
HIDROENERGJETIK”, SHOQËRISË “ARIS ALBANIA” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtime në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje “Për përdorim të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik”, shoqërisë “ARIS ALBANIA” sh.p.k., me vendndodhje, në pellgun ujëmbledhës të përroit të Grykës së Shellit, degë të lumit Mat, HEC “Shëlli”, në Bashkinë Mat, Qarku Dibër, sipas këtyre koordinatave:

Treguesit paraprak janë si më poshtë:

HEC “SHËLLI”

Vepra e marrjes:

- X= 510215.9
- Y= 4613117.6

- $Z=853$ m.m.n.d
- $Q_{mes}=0.188$ m³/s
- $Q_{llog}=0.4$ m³/s
- $Q_{eko}=0.019$ m³/s

Godina e Centralit:

- $X=507227.34$
- $Y=4613858.25$
- $Z=355$ m.m.n.d
- Fuqia e instaluar $N=1,518$ kWh
- Energjia Vjetore $E=4,086,276$ kWh/vit.

2. Zbatimi i lejes për përdorim burimi ujqor nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

